



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0265
Data e Vendimit: 16.04.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “DEMOS” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, iniciuar nga “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 16.04.2024, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik “DEMOS” SH.P.K.me nr. të protokollit 2024/0265, e datës 26.03.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, iniciuar nga “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 26.03.2024 ka pranuar ankesën me nr.0265/2024 nga “DEMOS” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” ndërsa me datë 31.01.2024 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK. OE ankues “DEMOS” SH.P.K. nuk ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrajnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: *“Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.”* Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: *“Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrajë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenin 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.*

AK -“MINISTRIA E SHËNDETËSISË” -, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me numër të prokurimit 206-24-573-1-1-1, megjithatë Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenin 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Megjithatë, OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues **nuk duhet** që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj kofom dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Po ashtu, zyra për financa, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - DEMOS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: